

20222854299

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për lëndët e para minerale (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16, 120/16, 189/16, 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 99/22), ministri i Ekonomisë miratoi

RREGULLORE PËR MËNYRËN E USHTRIMIT TË VLERËSIMIT (REVIZIONIT) PROFESIONAL TË DOKUMENTACIONIT GJEOLOGJIK

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Komisionit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik.

Neni 2

Vlerësimi (revizioni) profesional ushtrohet në dokumentacion gjeologjik për ushtrimin e hulumtimeve themelore, të prospektit dhe të detajuara gjeologjike.

Neni 3

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të një projekti për ushtrimin e hulumtimeve themelore gjeologjike deri te Komisioni për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) dorëzohet projekt për ushtrimin e hulumtimeve themelore gjeologjike (në tri kopje origjinale me CD) nga Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Enti Gjeologjik).

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të elaboratit për hulumtime themelore gjeologjike deri te Komisioni nga Enti Gjeologjik dorëzohet:

- kopje nga projekt për ushtrimin e hulumtimeve themelore gjeologjike dhe
- Elaborat për hulumtime themelore gjeologjike (në tre kopje origjinale me CD).

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të hartave gjeologjike me interpretues të të njëjtave deri te Komisioni nga Enti Gjeologjik dorëzohet:

- kopje nga projekt për ushtrimin e hulumtimeve themelore gjeologjike dhe
- harta gjeologjike me interpretues të të njëjtave, me gjithë dokumentacionin e tyre të bazës, terrenit dhe dokumentacionit tjetër (në tre kopje origjinale me CD).

Neni 4

Vlerësim (revizion) profesional të dokumentacionit gjeologjik për ushtrimin e hulumtimeve prospektuese ose të detajuara gjeologjike ushtrohet në bazë të kërkesës për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional nga poseduesi i koncesionit për hulumtime të detajuara gjeologjike ose eksploatim të lëndëve të para minerale, respektivisht poseduesi i dokumentacionit gjeologjik (në tekstin e mëtejshëm: kërkuesi).

Neni 5

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të projektit për ushtrimin e hulumtimeve prospektuese gjeologjike, në Entin Gjeologjik nga kërkuesi ndaj kërkesës dorëzohet:

- projekt për ushtrimin e hulumtimeve prospektuese gjeologjike në hapësirën në të cilën është dhënë koncesioni për hulumtime prospektuese gjeologjike (në tre kopje origjinale me CD),
- marrëveshje për koncesion për hulumtime prospektuese gjeologjike (original ose kopje të vërtetuar nga noteri) dhe

- dëshmi për pagesë të kryer të kompensimit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional.

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të elaboratit për hulumtimet e ushtruara gjeologjike prospektuese, Entit Gjeologjik nga kërkuesi bashkë me kërkesën i dorëzohet:

- elaborat për hulumtimet e ushtruara prospektuese gjeologjike (në tre kopje origjinale me CD),

- marrëveshje për koncesion për hulumtime prospektuese gjeologjike (origjinal ose kopje të vërtetuar nga noteri),

- fotokopje nga libri në të cilin udhëhiqen punët e ushtruara hulumtuese për hulumtimet prospektuese gjeologjike të nënshkruar nga personi i emëruar profesional për ushtrimin e mbikëqyrjes së hulumtimeve prospektuese gjeologjike dhe

- dëshmi për pagesën e bërë të kompensimit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional.

Neni 6

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të projektit për ushtrimin e hulumtimeve të detajuara gjeologjike, në Komisionin nga kërkuesi bashkë me kërkesën dorëzohet:

- projekt për ushtrimin e hulumtimeve të detajuara gjeologjike në hapësirën në të cilën është dhënë koncesioni për hulumtime të detajuara gjeologjike (në tre kopje origjinale me CD),

- marrëveshje për koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike (origjinal ose kopje të vërtetuar nga noteri), dhe

- dëshmi për pagesën e bërë të kompensimit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional.

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të elaboratit me përllogaritje të sasive të nevojshme të lëndëve të para minerale, në Komisionin nga kërkuesi bashkë me kërkesën dorëzohet:

- elaborat me përllogaritje të sasive të nevojshme të lëndëve të para minerale (në tre kopje origjinale me CD),

- leje për ndërtim të objektit të lëshuar nga organi kompetent (kopje e vërtetuar nga noteri) dhe

- dëshmi për pagesën e bërë të kompensimit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional.

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të elaboratit për hulumtime të ushtruara të detajuara gjeologjike, në Komisionin nga kërkuesi bashkë me kërkesën dorëzohet:

- elaborat për hulumtimet e detajuara gjeologjike (në tri kopje origjinale me CD),

- marrëveshje për koncesion për hulumtime të detajuara gjeologjike ose leje për hulumtime të detajuara gjeologjike (origjinal ose kopje të vërtetuar nga notari),

- fotokopje nga libri në të cilin udhëhiqen punët e ushtruara hulumtuese për hulumtimet e detajuara gjeologjike të nënshkruar nga personi i emëruar profesional për ushtrimin e mbikëqyrjes së hulumtimeve të detajuara gjeologjike dhe

- dëshmi për pagesën e bërë të kompensimit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional.

Për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional të elaboratit për rikategorizim të rezervave të xeheve, në Komisionin nga kërkuesi bashkë me kërkesën dorëzohet:

- elaborat për kategorizimin e rezervave të xeheve (në tre kopje origjinale me CD),

- marrëveshje për koncesion për eksploatimin e lëndëve të para minerale (origjinal ose kopje të vërtetuar nga notari),

- dëshmi për pagesën e bërë të kompensimit për ushtrimin e vlerësimit (revizionit) profesional.

Neni 7

Gjatë ushtrimit të vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik bëhet kontrolli respektivisht shqyrtimi dhe vlerësimi i:

- dokumentet e përgjithshme nëse përpiluesi i dokumentacionit gjeologjik objekt i revizionit i plotëson kushtet në përputhje me ligjin,
- libri në të cilin udhëhiqen punët e ushtruara hulumtuese për hulumtimet e detajuara prospektuese ose të detajuara gjeologjike të nënshkruar nga personi i emëruar për ushtrimin e mbikëqyrjes së hulumtimeve të detajuara prospektuese ose të detajuara gjeologjike,
- përmbajtja e dokumentacionit gjeologjik objekt i revizionit, respektivisht nëse e njëjta është përpiluar në përputhje me Ligjin për lëndë të para minerale (*) dhe akte nënligjore të miratuara në bazë të të njëjtit dhe
- teksti, dokumentacioni grafik dhe materiali dokumentues i dokumentacionit gjeologjik lëndë e revizionit.

Neni 8

Gjatë ushtrimit të vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik nga Komisioni, respektivisht nga Enti Gjeologjik, më së voni në afat prej 90 ditëve nga dita e dorëzimit të dokumentacionit nga neni 3 i kësaj rregullore, respektivisht të kërkesës me dokumentacionin nga nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, përpilohet raport i revizionit dhe lëshohet klauzolë e revizionit.

Raporti i revizionit nga paragrafi 1 i këtij neni përmban të dhëna nga kontrolli, respektivisht shqyrtimi i dokumenteve nga neni 7 i kësaj rregullore, si dhe:

- shqyrtim i përmbajtjes së dokumentacionit gjeologjik objekt i revizionit, respektivisht nëse e njëjta është përpiluar në përputhje me Ligjin për lëndë të para minerale (*) dhe akte nënligjore të miratuara në bazë të të njëjtit,
- konstatime dhe vërejtje ndaj tekstit, dokumentacionit grafik dhe materialit dokumentues të dokumentacionit gjeologjik lëndë e revizionit,
- vërejtje dhe afat për korrigjimin e tyre dhe
- rekomandim për lëshimin e klauzolës së revizionit.

Neni 9

Nëse përpiluesi i dokumentacionit gjeologjik lëndë e revizionit nuk vepron ndaj vërejtjeve nga raporti i revizionit nga neni 8 i kësaj rregulloreje në afat të përcaktuar, dokumentacioni gjeologjik lëndë e revizionit nuk pranohet nga Komisionit respektivisht Enti Gjeologjik, me aktvendim, me çka përfundon procedura.

Neni 10

Klauzola e revizionit nga vlerësimi (revizioni) i bërë profesional i dokumentacionit gjeologjik për ushtrimin e hulumtimeve të detajuara gjeologjike lëshohet në tri kopje origjinale dhe e njëjtat së bashku me dokumentacionin gjeologjik lëndë e revizionit mbeten në Entin Gjeologjik.

Klauzola e revizionit nga vlerësimi (revizioni) i bërë profesional i dokumentacionit gjeologjik për ushtrimin e hulumtimeve prospektuese dhe të detajuara gjeologjike lëshohet në tri kopje origjinale nga të cilat dy kopje janë për kërkuesin, ndërsa një kopje e së njëjtës, si dhe një ekzemplar nga dokumentacioni gjeologjik lëndë e revizionit mbeten në Entin Gjeologjik.

Gjatë lëshimit të klauzolës së revizionit bëhet vërtetimi në tre kopje të rishikuara të dokumentacionit gjeologjik për ushtrimin e hulumtimeve themelore, prospektuese ose të detajuara gjeologjike nga Enti Gjeologjik.

Neni 11

Me ditë e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja për mënyrën e ushtrimit të vlerësimit (revizionit) profesional të dokumentacionit gjeologjik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 65/11).

Neni 12

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 24-5418/1
9.12.2022
Shkup

Ministri i Ekonomisë,
Kreshnik Bekteshi, d.v.